

## Notfallzentrum für Kinder und Jugendliche (NZKJ)



(Qendra emergjente për fëmijë e të rinj)

### Drejtoria e klinikës

“Notfallzentrum für Kinder und Jugendliche“ NZKJ-ja është portali hyrës drejt klinikave të pediatriisë.

Ndodhja e një emergjence është një ngjarje e papritur për gjithë familjen. Një trajtim optimal, që merr parasysh kërkesat e pacientëve, është një dëshirë e fortë e drejtorisë së klinikës dhe e gjithë ekipit.

---

### Kontakti

Fëmija juaj është i sëmurë por pediatri ose mjeku juaj i familjes nuk kapet? Me anë të telefonit të spitalit pediatrik gjeni këshillimin tonë emergjent pediatrik në çdo orë të ditës.

Telefoni / Faksi

- Këshillim emergjent pediatrik: telefoni i spitalit pediatrik (me detyrim shpenzimi; CHF 0.95/min) +41 (0)900 632 927
- Shërbim emergjent 24-orësh: (pa këshillim telefonik) +41 (0)31 632 92 77
- Faksi drejt sportelit pranues të emergjencave: +41 (0)31 632 52 99

### Adresa

Notfallzentrum für Kinder und Jugendliche NZKJ  
Inselspital  
3010 Bern

Lëvdime dhe kritikime me gjithë kënaqësi pranojmë me anë të e-mail-it. Jo regjistrime pacientash!

---

## Udhëzuesi

Kontakti me telefon

- Pritja dhe triazhi (përcaktimi) i NZKJ-së (regjistrimi / pranimi 24-orësh) +41 (0)31 632 92 77
- Sekretariati i drejtorisë i NZKJ-së +41 (0)31 632 54 68
- Faksi drejt sportelit pranues të emergjencave +41 (0)31 632 52 99
- Centrali telefonik i Inselspitalit +41 (0)31 632 21 11
- Lëvdim dhe kritikim: e-mail

## Udhëzime të jashtme drejt “Notfallzentrum für Kinder und Jugendliche“ (NZKJ)

*Në raste emergjente*

Ju lutemi regjistrohuni tek mjeku në shërbim të NZKJ-së (24-orësh, nëpërmjet sportelit pranues të NZKJ-së 031 632 92 77, kërkuesi i brendshëm 8111) dhe eventualisht faksi drejt sportelit pranues të emergjencave.

*Në raste jo-emergjente* (hyrja “gjysëm vulnetare” ose poliklinika e zënë etj.)

Pas konsultimit të mëparshëm të udhëzuesit me specialistët e pediatriisë ose të kirurgjisë së fëmijëve nëpërmjet centralit telefonik të Inselspitalit.

Në rast paqartësie ju lutemi konsultohuni me kryemjekun në shërbim të NZKJ-së (ora 7:30 deri 24:00, nëpërmjet sportelit pranues të NZKJ-së 031 632 92 77, kërkuesi i brendshëm 8110).

Ju lutemi regjistrohuni tek mjeku në shërbim të NZKJ-së (24-orësh, nëpërmjet centralit telefonik të Inselspitalit, kërkuesi i brendshëm 8111) dhe eventualisht faksi drejt sportelit pranues të emergjencave.

.....

“Notfallzentrum für Kinder und Jugendliche“ e Inselspitalit është e hapur 24 orë çdo ditë në



365 ditë të vitit për pacientë nën moshën 16 vjeç (deri në ditëlindjen e 16-të).

NZKJ-ja çdo vit kujdeset për rreth 20'000 pacientë.

Ekipi ynë ndërfaqshor trajton në menyrë kompetente pacientë me sëmundje e plagosje më të rënda si edhe të thjeshta.

Një trajtim optimal, që merr parasysh kërkesat e pacientëve, është për ne një dëshirë e fortë. Vlerësimi juaj është i rëndësishëm për ne dhe na ndihmon në këtë.

## Zhvillimi nga hyrja deri në dalje



### Hyrja

Pacientët tanë arrijnë ose me dëshirën e prindërve ose sipas udhëzimit nga mjeku familjar të shoqëruar nga prindërit ose të afërmit, ose ata transferohen nëpërmjet shërbimit emergjent.

### Pritja dhe triazhi (përcaktimi)

Infermierë të provuar dhe të shkolluar presin pacientët dhe shoqëruesit e tyre.

Ata punojnë sipas konceptit të triazhit (përcaktimit) ATS (Australasian Triage Scale) dhe kanë dijenitë e thelluara në vlerësimin e foshnjeve të sëmura e të plagosura dhe të fëmijëve e të rinjve të sëmurë e të plagosur. Pacientët ndahen sipas gradit të rëndësisë së sëmundjes/plagosjes në kategorinë përkatëse të urgjencës.



### Afate pritjeje



Raste emergjente nuk planifikohen, prandaj afate pritjeje janë të pashmangshme. Radha e trajtimit përcaktohet nga gradi i rëndësisë së sëmundjes/plagosjes.

Lodra, revista dhe gazeta janë në dispozicion të pacientëve tanë dhe të afërmëve të tyre në zonën e pritjes.

Nëse ndryshohet/përkeqësohet gjendja e pacientit ose në rast pasigurie ju mund të paraqituni në çdo kohë sërish tek sporteli i pritjes.

### Trajtimi

Fëmija/i riu parësisht trajtohet nga ekipi i qendrës emergjente. Ky vendos bashkë me ju për analizat e nevojshme dhe për trajtimin.



### Dalja



Sipas zhvillimit fëmija/i riu ose lëshohet për në shtëpi, ose për maksimalisht 24 orë mbikëqyrjet në stacionin e mbikëqyrjes të qendrës emergjente, ose transferohet në njërin të klinikave pediatrike të Inselspitalit (kirurgjike ose mjeksore).

## Ardhja

“Notfallzentrum für Kinder und Jugendliche“ gjindet nën hyrjen 31c (shihni planin e lokalitetit).

### ... me makinë

Nëpërmjet autostradës A1: Dalja “Forsthaus“, pastaj ndiqni tabelat "Inselspital". Hyrja për në “Notfallzentrum für Kinder und Jugendliche“ gjindet në anën e majtë (shihni tabelat).

Hyrja në makinë dhe dalja nga makina para qendrës emergjente është e mundur, pastaj ju lutemi parkoni diku tjetër. Në areal janë në dispozicion vetëm shumë pak vende parkimi për kohë të skurtër.

Mjaft vende parkimi mund të gjeni në “Insel-Parking“ (në planin e lokalitetit i shënuar me "P").



### ... me mjete të qarkullimit publik



Autobuzi nr. 11 (drejtim “Güterbahnhof“) që nga stacioni hekurudhor ose “Hirschengraben“ deri tek Inselspitali, makina e postës 101 që nga stacioni hekurudhor ose rruga “Schanzenstrasse“ deri tek Inselspitali.

Udhëtarë me tren: Ju dilni nga peroni në drejtim

perëndimor (rrugëkalimi "Welle") nëpërmjet shkallës së levizshme ose ashensorit. Makina e postës 101 ndalet pak më poshtë rrugëkalimit "Welle" në rrugën “Schanzenstrasse“. Për në autobus nr. 11 ju shkonni djathtas reth këndit në rrugën “Laupenstrasse “ (stacioni “Hirschengraben“).

---

## Përkujdesja tek “Notfallzentrum für Kinder und Jugendliche“

Ekipi ynë përkujdesor përbëhet nga afërsisht 40 bashkëpunëtorë. Të gjithë infermierë kanë eksperiencën profesionale disavjeçare. Disa kanë tashme një përvojë dhjetërvjeçare me raste emergjente dhe nëpërmjet kësaj garantojnë veç të tjerëve një introduktim kompetent të kolegeve të reja/kolegëve të rinj në fushën speciale të mjekësisë emergjente. Përkujdesja mbështetet në menyrë efikase nga dy të punësuar profesionalë për shëndetin (FAGE).



Mundësi të ndryshme të kualifikimit profesional të thelluar janë në dispozicion të bashkëpunëtorëve të rinj pas një kohe introduktimi një deri dy vjeçare të planizuar në menyrë të kujdesshme: Kursi i brendshëm i “Insel“-it “Intermediate Care për fëmijë“ (zgjatja 8 muaj), studimi pasdiplome dyvjeçar për përkujdesje emergjente, një studim pasdiplome për këshillim përkujdesjeje ose ndjekja e moduleve të përzgjedhura të kualifikimeve të tjera. Secili vë në dispozicion dijeninë e tij profesionale për përkujdesjen sa më të mirë të pacientëve dhe të afermëve.

## Koncepti i triazhit (përcaktimit) ATS (Australasian Triage Scale)

Një triazh duhet të garantojë, që pacientët e emergjencës të udhëzohen sipas shqetësimeve të tyre dhe sipas urgjencës në kohën e duhur drejt trajtimit përkatës.

Infermierët tanë të specialisuar dhe të provuar kanë dijeni të thelluara për vlerësimin e foshnjeve, fëmijëve dhe të rinjve. Çdo pacient vlerësohet në hyrje sipas konceptit të triazhit (përcaktimit) ATS (Australasian Triage Scale). Sipas gradit të rëndësisë së sëmundjes ose të plagosjes përcaktohet urgjenca e konsultimit.